<p>cigareve elektronike që përmbajnë aditivë nga neni 23 paragrafi 3 i këtij ligji në cilëndo pjesë apo përmbajtje të tyre, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në lëngun apo përmbajtjen tjetër që përmban nikotinë, fishek, enë - kontejner, apo rezervuar dhe pajisjen pa fishek, enë apo rezervuar.</p> <p>4.Ndalohet vendosja në treg e produkteve të ngjashme apo imituese të cigareve elektronike që përmbajnë aroma karakteristike apo aditivë nga neni 26 paragrafi 3 i këtij ligji të cilat prodhojnë avull apo aerosolë pa nikotinë.</p> <p>5.Prodhuesit dhe importuesit e cigareve elektronike dhe enëve për rimbushje janë të detyruar të informojnë ministrinë përgjegjëse për Tregti për të gjitha produktet e tilla që synojnë të nxjerrin në treg. Njoftimi dorëzohet në formë elektronike gjashtë muaj përpara vendosjes së synuar në treg. Për cigaret elektronike dhe enëve për rimbushje që janë vendosur tashmë në treg në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, njoftimi duhet të dorëzohet brenda gjashtë muajve nga kjo datë. Një njoftim i ri dërgohet për çdo modifikim të rëndësishëm të produktit. Në varësi të faktit nëse produkti është një cigare elektronike ose një enë për rimbushje, njoftimi përmban informacionin si ne vijim:</p>	<p>market electronic cigarettes that contain additives under Article 23 paragraph 3 of this Law in any of their parts or contents, including but not limited to nicotine-containing liquid or other contents, cartridge, refill container, or tank and device without cartridge, refill container, or tank.</p> <p>4.The placing on the market of products similar to or imitating electronic cigarettes that contain characterising flavours or additives under Article 26 paragraph 3 of this Law, which produce vapor or aerosols without nicotine, shall be prohibited.</p> <p>5.Manufacturers and importers of electronic cigarettes and refill containers shall be obliged to inform the Ministry responsible for Trade of all such products that they intend to put on the market. The notification is submitted in electronic form six months before the intended placing on the market. For electronic cigarettes and refill containers already placed on the market on the date of entry into force of this Law, the notification must be submitted within six months of this date. A new notification shall be sent for any significant product modifications. Depending on whether the product is an electronic cigarette or a refill container, the notice shall contain the following information:</p>	<p>elektronskih cigareta koje sadrže aditive iz člana 23. stav 3. ovog zakona u bilo kom svom delu ili sadržaju, uključujući ali ne ograničavajući se na tečnost ili drugi sadržaj koji sadrži nikotin, uložak, posudu – kontejner, ili rezervoar i uređaj bez uložka, posude ili rezervoara.</p> <p>4.Zabranjeno je stavljanje u promet sličnih ili kopija proizvoda elektronskih cigareta koji sadrže karakteristične arome ili aditive iz člana 26. stav 3. ovog zakona, koji proizvode paru ili aerosol bez nikotina.</p> <p>5.Proizvođači i uvoznici elektronskih cigareta i posuda za ponovno punjenje dužni su da obaveste MIPT o svim takvim proizvodima koje nameravaju da stave u promet. Obaveštenje se dostavlja u elektronskoj formi šest meseci pre nameravanog stavljanja u promet. Za elektronske cigarete i posude za ponovno punjenje koje su već stavljene u promet na dan stupanja na snagu ovog zakona, obaveštenje se mora dostaviti u roku od šest meseci od ovog dana. Novo obaveštenje se šalje za sve značajne izmene proizvoda. U zavisnosti od toga da li je proizvod elektronska cigareta ili posuda za ponovno punjenje, obaveštenje sadrži sledeće informacije:</p>
---	--	--

<p>5.1.emrin dhe detajet e kontaktit të prodhuesit dhe importuesit,</p> <p>5.2.një listë të të gjithë përbërësve që përmban produkti dhe emetimet që vijnë nga përdorimi i produktit, sipas markës dhe llojit, duke përfshirë sasitë e tyre,</p> <p>5.3.të dhënat toksikologjike në lidhje me përbërësit dhe emetimet e atij produkti, duke përfshirë edhe kohën kur ato ngrohen, të cilat lidhen veçanërisht me efektet e tyre në shëndetin e konsumatorëve kur thithen dhe duke marrë parasysh, ndër të tjera, çdo efekt të varësisë,</p> <p>5.4.informacion rreth dozës dhe marrjes së nikotinës kur konsumohet në kushte të zakonshme ose të arsyeshme të parashikueshme;</p> <p>5.5.përshkrimin e pjesëve përbërëse të produktit, duke përfshirë, ku është e zbatueshme, mekanizmin për hapjen dhe mbushjen e cigares elektronike ose kontejnerit të mbushjes;</p> <p>5.6.një përshkrim të procesit të prodhimit, duke përfshirë nëse ai përfshin prodhimin serik, dhe një</p>	<p>5.1.the name and contact details of the manufacturer and importer,</p> <p>5.2.a list of all the ingredients contained in the product and the emissions resulting from the use of the product, by brand and type, including their quantities,</p> <p>5.3.toxicological data relating to the ingredients and emissions of that product, including the time when they are heated, which relate in particular to their effects on the health of consumers when inhaled and taking into account, inter alia, any addictive effects,</p> <p>5.4.information about the dose and intake of nicotine when consumed under usual or reasonably foreseeable conditions;</p> <p>5.5.description of the component parts of the product, including, where applicable, the mechanism for opening and filling the electronic cigarette or refill container;</p> <p>5.6.a description of the manufacturing process, including whether it involves serial production, and a statement that the</p>	<p>5.1.naziv i kontakt podatke proizvođača i uvoznika,</p> <p>5.2.spisak svih sastojaka sadržanih u proizvodu i emisija koje proizilaze iz upotrebe proizvoda, po brendu i vrsti, uključujući njihove količine,</p> <p>5.3.toksikološke podatke koji se odnose na sastojke i emisije tog proizvoda, uključujući vreme kada su zagrevani, koji se posebno odnose na njihov uticaj na zdravlje potrošača kada se udiše i, uzimajući u obzir, između ostalog, sve efekte zavisnosti,</p> <p>5.4.informacije o dozi i unosu nikotina kada se konzumira pod uobičajenim ili razumno predvidivim uslovima;</p> <p>5.5.opis sastavnih delova proizvoda, uključujući, gde je primenljivo, mehanizam za otvaranje i punjenje elektronske cigarete ili posude za punjenje;</p> <p>5.6.opis procesa proizvodnje, uključujući da li se radi o serijskoj proizvodnji, i izjavu da proizvodni proces obezbeđuje usklađenost</p>
---	--	---

<p>deklaratë që procesi i prodhimit siguron përputhjen me kërkesat e këtij neni;</p> <p>5.7.një deklaratë që prodhuesi dhe importuesi mbajnë përgjegjësi të plotë për sasinë dhe sigurinë e produktit kur vendoset në treg dhe përdoret në rrethana normale ose kushte të arsyeshme të parashikueshme.</p> <p>6.Kur ministria përkatëse për Tregti vlerëson se të dhënat e paraqitura janë jo të plota, do të kërkojë plotësimin e të dhënave.</p> <p>7.Ministria obligon prodhuesit dhe importuesit tarifa proporcionale për pranimin, ruajtjen, trajtimin dhe publikimin e të dhënave që u dorëzohen.</p> <p>8.Prodhuesit dhe importuesit janë të detyruar të sigurojnë që:</p> <p>8.1.lëngu që përmban nikotinë të vendoset në treg vetëm në enë - kontejnerë të veçantë për rimbushje që nuk tejkalojnë vëllimin prej 10 ml, në cigare elektronike të ose në fishekë me një përdorim të vetëm dhe që fishekët ose rezervuarët nuk kalojnë vëllimin prej 2 ml;</p>	<p>manufacturing process ensures compliance with the requirements of this Article;</p> <p>5.7.a statement that the manufacturer and importer take full responsibility for the quantity and safety of the product when placed on the market and used under normal circumstances or reasonably foreseeable conditions.</p> <p>6.When the relevant Ministry for Trade assesses that the submitted data is incomplete, it shall request the completion of the data.</p> <p>7.The Ministry shall oblige manufacturers and importers to pay proportional fees for receiving, storing, handling and publishing the data submitted to them.</p> <p>8.Manufacturers and importers shall be obliged to ensure that:</p> <p>8.1.the nicotine-containing liquid is placed on the market only in containers - separate refill containers not exceeding 10 ml in volume, in electronic cigarettes or in single-use cartridges and that cartridges or tanks do not exceed 2 ml in volume;</p>	<p>sa zahtevima ovog člana;</p> <p>5.7.izjavu da proizvođač i uvoznik snose punu odgovornost za količinu i bezbednost proizvoda kada se stavlja u promet i koristi pod normalnim okolnostima ili razumno predvidivim uslovima.</p> <p>6.Kada relevantno Ministarstvo za Trgovinu oceni da su dostavljeni podaci nepotpuni, zatražiće dopunu podataka.</p> <p>7.Ministarstvo obavezuje proizvođače i uvoznike da plaćaju srazmerne naknade za prijem, čuvanje, obradu i objavljivanje podataka koji su im dostavljeni.</p> <p>8.Proizvođači i uvoznici su dužni da obezbede da:</p> <p>8.1.tečnost koja sadrži nikotin stavljaju u promet samo u specijalnim posudama – kontejnerima za ponovno punjenje koje ne prelaze zapreminu od 10 ml, u elektronskim cigaretama ili u ulošcima za jednokratnu upotrebu i da ulošci ili rezervoari ne prelaze zapreminu od 2 ml;</p>
---	--	---

<p>8.2.lëngu apo përmbajtja tjetër që përmban nikotinë të mos përmbajë më shumë se 20 mg/ml nikotinë;</p> <p>8.3.lëngu apo përmbajtja tjetër që përmban nikotinë nuk përmban aditivë nga neni 23 paragrafi 3 i këtij ligji;</p> <p>8.4.vetëm përbërës me pastërti të lartë përdoren për prodhimin e lëngjeve që përmbajnë nikotinë. Substancat që nuk janë të përcaktuara ndër përbërësit nga paragrafi 5 nën paragrafi 5.2 të këtij neni mund të jenë të pranishme në lëngun që përmban nikotinë vetëm në gjurmë, nëse teknikisht është e pamundur të shmangen këto gjurmë gjatë prodhimit;</p> <p>8.5.përveç nikotinës, përbërësit e vetëm të përdorur në lëngun që përmban nikotinë nuk përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut në formë të nxehtë ose të pa ngrohur;</p> <p>8.6.cigaret elektronike çlirojnë doza të nikotinës në nivele uniforme;</p> <p>8.7.cigaret elektronike dhe enët e rimbushjes të jenë të tilla që fëmijët nuk mund t'i përdorin dhe që ndryshimet e paautorizuara nuk janë të</p>	<p>8.2.the liquid or other content containing nicotine not to contain more than 20 mg/ml of nicotine;</p> <p>8.3.the liquid or other content containing nicotine does not contain additives under Article 23 paragraph 3 of this Law;</p> <p>8.4.only high-purity ingredients are used to produce nicotine-containing liquids. Substances that are not defined among the ingredients under paragraph 5 subparagraph 5.2 of this Article may be present in the liquid containing nicotine only in traces, if it is technically impossible to avoid these traces during production;</p> <p>8.5.except for nicotine, the only ingredients used in nicotine-containing liquid do not pose a risk to human health in heated or unheated form;</p> <p>8.6.electronic cigarettes release doses of nicotine at uniform levels;</p> <p>8.7.electronic cigarettes and refill containers are such that children cannot use them and that unauthorized changes are not possible, and that they are</p>	<p>8.2.tečnost ili drugi sadržaj koji sadrži nikotin ne sme da sadrži više od 20 mg/ml nikotina;</p> <p>8.3.tečnost ili drugi sadržaj koji sadrži nikotin ne sadrži aditive iz člana 23. stav 3. ovog zakona;</p> <p>8.4.samo sastojci visoke čistoće se koriste za proizvodnju tečnosti koje sadrže nikotin. Supstance koje nisu propisane među sastojcima iz stava 5. tačka 5.2. ovog člana mogu biti prisutne u tečnosti koja sadrži nikotin samo u tragovima, ako je tehnički nemoguće izbeći te tragove u toku proizvodnje;</p> <p>8.5.osim nikotina, jedini sastojci koji se koriste u tečnosti koja sadrži nikotin ne predstavljaju rizik po ljudsko zdravlje u zagrejanom ili nezagrejanom obliku;</p> <p>8.6.elektronske cigarete oslobađaju doze nikotina na ujednačenim nivoima;</p> <p>8.7.elektronske cigarete i posude za ponovno punjenje su takve da deca ne mogu da ih koriste i da neovlašćene promene nisu moguće, i da su zaštićene od lomljenja,</p>
---	--	---



<p>mundshme, dhe se ato janë të mbrojtura nga thyerja, rrjedhja dhe të kenë mekanizëm që siguron rimbushje pa rrjedhje.</p> <p>9.Çdo njësi paketë e cigareve elektronike dhe ene të rimbushshme duhet të përmbajë një fletëpalosje me informacionin si ne vijim:</p> <p>9.1.udhëzime për përdorimin dhe ruajtjen e produktit, duke përfshirë njoftimin se përdorimi i produktit nuk rekomandohet për të rinjtë dhe jo-duhanpirësit;</p> <p>9.2.kundërrindikacionet;</p> <p>9.3.një paralajmërim për grupe të veçanta rreziku;</p> <p>9.4.efektet e mundshme të dëmshme;</p> <p>9.5.për varësinë dhe toksicitetin dhe;</p> <p>9.6.për vendosjen e kontakteve me prodhuesin ose importuesin dhe një person juridik ose fizik për kontakt në Bashkimin Evropian.</p> <p>10.Çdo njësi paketimi dhe paketimi i jashtëm i cigareve elektronike dhe enëve-kontejnerëve për rimbushje duhet:</p>	<p>protected against breakage, leakage and have a mechanism that ensures leak-free refilling.</p> <p>9.Each unit package of electronic cigarettes and refill containers must contain a leaflet with the following information:</p> <p>9.1.instructions for use and storage of the product, including a reference that the product is not recommended for use by young people and non-smokers;</p> <p>9.2.contra-indications;</p> <p>9.3.warning for specific risk groups;</p> <p>9.4.possible adverse effects;</p> <p>9.5.addictiveness and toxicity, and</p> <p>9.6.for establishing contacts with the manufacturer or importer and a legal or natural person for contact in the European Union.</p> <p>10.Each unit package and outside packaging of electronic cigarettes and refill containers must:</p>	<p>curenja i imaju mehanizam koji obezbeđuje ponovno punjenje bez curenja.</p> <p>9.Svako pojedinačno pakovanje elektronskih cigareta i posuda za ponovno punjenje moraju da sadrže letak sa sledećim informacijama:</p> <p>9.1.uputstva za upotrebu i skladištenje proizvoda, uključujući obaveštenje da se upotreba proizvoda ne preporučuje mladima i nepušačima;</p> <p>9.2.kontraindikacije;</p> <p>9.3.upozorenje za posebne rizične grupe;</p> <p>9.4.potencijalni štetni efekti;</p> <p>9.5.zavisnost i toksičnost; i</p> <p>9.6.informacije za uspostavljanje kontakata sa proizvođačem ili uvoznikom i pravnim ili fizičkim licem za kontakt u Evropskoj uniji.</p> <p>10.Svako pojedinačno pakovanje i grupno pakovanje elektronskih cigareta i posuda - kontejnera za ponovno punjenje moraju da:</p>
--	--	---

<p>10.1.të përfshijë një listë të të gjithë përbërësve të përfshirë në produkt në rend zbritës sipas peshës dhe informacionit mbi përmbajtjen e nikotinës së produktit dhe lirim për dozë, numrin serik dhe një rekomandim për ta mbajtur produktin larg fëmijëve.</p> <p>10.2.përmbajnë të dhëna për përmbajtjen e nikotinës në ene dhe de nuk ka aroma të shtuara.</p> <p>10.3.të mbajë paralajmërimin e mëposhtëm shëndetësor: »<i>Ky produkt përmban nikotinë, i cili shkakton varësi të fortë dhe është i dëmshëm për shëndetin</i>”.</p> <p>11.Çdo paketim njësi dhe çdo paketim i jashtëm; duhet të përmbajë paralajmërimet shëndetësore në pajtim me dispozitat e nenit 26, paragrafët 2 dhe 3 të këtij ligji.</p> <p>12.Aktivitetet si në vijim janë të ndaluara:</p> <p>12.1.botime komerciale në shërbimet e shoqërisë së informacionit, në shtyp dhe botime të tjera të shtypura, me qëllim që të kenë një efekt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në</p>	<p>10.1.include a list of all ingredients included in the product in descending order by weight and information on the product's nicotine content and release per dose, the serial number and a recommendation to keep the product away from children.</p> <p>10.2.contain data on the nicotine content in the container and no added flavours.</p> <p>10.3.carry the following health warning: <i>"This product contains nicotine which is a highly addictive substance and is harmful to health"</i>.</p> <p>11.Any unit packaging and any outside packaging; must contain health warnings in accordance with the provisions of Article 26, paragraphs 2 and 3 of this Law.</p> <p>12.The following activities shall be prohibited:</p> <p>12.1.commercial publications in information society services, in the press and other printed publications, in order to have a direct or indirect effect on the promotion of electronic cigarettes and</p>	<p>10.1.sadrže listu svih sastojaka sadržanih u proizvodu u opadajućem redosledu prema težini i informacijama o sadržaju nikotina u proizvodu i oslobađanju po dozi, serijski broj i preporuku da proizvod držite dalje od dece.</p> <p>10.2.sadrže informacije o sadržaju nikotina u posudi i da nema dodatih aroma.</p> <p>10.3.nose sledeće zdravstveno upozorenje: <i>„Ovaj proizvod sadrži nikotin, koji izaziva veliku zavisnost i štetan je po zdravlje“</i>.</p> <p>11.Svako pojedinačno pakovanje i grupno pakovanje; mora da sadrži zdravstvena upozorenja u skladu sa odredbama člana 26. stavovi 2. i 3. ovog zakona.</p> <p>12.Sledeće aktivnosti su zabranjene:</p> <p>12.1.komercijalne publikacije u službama informacionog društva, u štampi i drugim štampanim izdanjima, kako bi direktno ili indirektno uticali na promociju elektronskih cigareta i posuda koje se mogu ponovo</p>
--	--	---

<p>promovimin e cigareve elektronike dhe enëve të rimbusheshme, me përjashtim të botimeve të destinuara ekskluzivisht për profesionistët e përfshirë në tregtinë e pajisjeve elektronike cigare ose enëve të rimbushura me botime të shtypura dhe të publikuara në vende të treta.</p> <p>12.2.njoftimet komerciale në radio, televizion, portale dhe platforma në internet me qëllim që të kenë një efekt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në promovimin e cigareve elektronike dhe enëve rimbushëse.</p> <p>12.3.çdo formë kontributi publik ose privat në programet radiofonike televizive, portale dhe platforma në internet me qëllim promovimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të cigareve elektronike dhe enëve rimbushëse.</p> <p>12.4.çdo formë e kontributit publik ose privat për çdo ngjarje, aktivitet ose individ me qëllim të promovimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të cigareve elektronike dhe enëve të rimbushshëm që përfshin ose zhvillohet në vendet tjera.</p>	<p>refill containers, with the exception of publications intended exclusively for professionals involved in the trade of electronic cigarette devices or refill containers with printed publications and published in third countries.</p> <p>12.2.commercial radio, television, portal and internet platform announcements intended to have a direct or indirect effect on the promotion of electronic cigarettes and refill containers.</p> <p>12.3.any form of public or private contribution to radio, television programs, portals and internet platforms for the direct or indirect promotion of electronic cigarettes and refill containers.</p> <p>12.4.any form of public or private contribution to any event, activity or individual for the purpose of direct or indirect promotion of electronic cigarettes and refill containers that involves or takes place in other countries.</p>	<p>puniti, sa izuzetkom publikacija namenjenih isključivo profesionalcima koji se bave trgovinom uređaja za elektronske cigarete ili posuda za ponovno punjenje sa publikacijama koje su štampane i objavljene u trećim zemljama.</p> <p>12.2.komercijalne objave na radiju, televiziji, portalima i internet platformama u cilju direktnog ili indirektnog uticaja na promociju elektronskih cigareta i posuda za ponovno punjenje.</p> <p>12.3.bilo koji oblik javnog ili privatnog doprinosa radio, televizijskim programima, portalima i internet platformama u cilju direktnog ili indirektnog uticaja na promociju elektronskih cigareta i posuda za ponovno punjenje.</p> <p>12.4.bilo koji oblik javnog ili privatnog doprinosa bilo kom događaju, aktivnosti ili pojedincu u svrhu direktne ili indirektno promocije elektronskih cigareta i posuda za ponovno punjenje koji uključuje ili se odvija u drugim zemljama.</p>
--	---	--

<p>12.5.shpalljet komerciale audiovizive për të cilat zbatohet një rregullore e veçantë për mediat elektronike, në lidhje me cigaret elektronike dhe enët rimbushse.</p> <p>13.Prodhuesit dhe importuesit e cigareve elektronike dhe enëve të rimbushme janë të detyruara t'i paraqesin ministrisë përgjegjëse për financat jo më vonë se 31 mars i vitit aktual për vitin paraprak:</p> <p>13.1.të dhëna gjithëpërfshirëse për vëllimin e shitjeve sipas markës dhe llojit të produktit;</p> <p>13.2.informacion mbi preferencat e grupeve të ndryshme të konsumatorëve, duke përfshirë të rinjtë, jo duhanpirësit dhe grupet kryesore të përdoruesve aktualë;</p> <p>13.3.mënyrat e shitjes së produkteve;</p> <p>13.4.përmbledhjet e të gjitha hulumtimeve të tregut të kryera në lidhje me sa më sipër në gjuhët zyrtare.</p> <p>14.Ministria përgjegjëse për Tregti, do t'i publikojë informacionet e marra në bazë të paragrafit 5 të këtij neni në ueb faqen e saj,</p>	<p>12.5.audio-visual commercials to which a special regulation for electronic media applies, in relation to electronic cigarettes and refillable containers.</p> <p>13.Manufacturers and importers of electronic cigarettes and refill containers shall be obliged to submit to the Ministry responsible for finances no later than 31 March of the current year for the previous year:</p> <p>13.1.comprehensive data on sales volume by brand and product type;</p> <p>13.2.information on the preferences of different consumer groups, including young people, non-smokers and the main groups of current users;</p> <p>13.3.ways of selling products;</p> <p>13.4.summaries of all market research conducted in relation to the above in the official languages.</p> <p>14.The Ministry responsible for Trade shall publish the information received on the basis of paragraph 5 of this Article on its website, taking</p>	<p>12.5.audiovizuelne komercijalne objave na koje se primenjuje poseban propis za elektronske medije, u vezi sa elektronskim cigaretama i posudama za ponovno punjenje.</p> <p>13.Proizvođači i uvoznici elektronskih cigareta i posuda za ponovno punjenje dužni su da dostave nadležnom ministarstvu za finansija najkasnije do 31. marta tekuće godine za prethodnu godinu:</p> <p>13.1.sveobuhvatne podatke o obimu prodaje po brendu i vrsti proizvoda;</p> <p>13.2.informacije o preferencijama različitih grupa potrošača, uključujući mlade ljude, nepušače i glavne grupe trenutnih korisnika;</p> <p>13.3.naçine prodaje proizvoda;</p> <p>13.4.sažetke svih istraživanja tržišta sprovedenih u vezi sa gore navedenim na službenim jezicima.</p> <p>14. Ministarstvo nadležno za trgovinu će informacije dobijene na osnovu stava 5. ovog člana objaviti na svojoj internet stranici, vodeći računa i</p>
--	--	--

<p>duke marrë parasysh dhe zbatuar mbrojtjen e të dhënave që prodhuesit dhe importuesit i kanë shënuar si sekret afarist me rastin e dorëzimit të të dhënave të tilla.</p> <p>15.Prodhuesit, importuesit dhe shpërndarësit e cigareve elektronike dhe enëve të rimbushshëm janë të detyruar të krijojnë dhe mbajnë një sistem për mbledhjen e informacionit për të gjitha efektet e dëmshme të dyshuara të këtyre produkteve në shëndetin e njeriut.</p> <p>16.Nëse ndonjë prodhues, importues ose shpërndarës ka njohuri ose arsye për të dyshuar se cigaret elektronike ose enët për rimbushje në zotërim dhe që synohen të vendosen në treg ose janë vendosur në treg janë të pasigurta ose të cilësisë së dobët ose në ndonjë mënyrë tjetër nuk janë në përputhje me këtë ligj, është e detyrueshme që menjëherë të ndërmerren të gjitha masat korrigjuese të nevojshme për ta sjellë atë produkt në përputhje me këtë ligj, për ta tërhequr ose revokojë atë, varësisht nga rrethanat e rastit konkret. Në këtë rast, prodhuesi, importuesi ose shpërndarësi është i detyruar të informojë menjëherë autoritetet e mbikëqyrjes së tregut, ku produkti është i disponueshëm ose synon të vihet në dispozicion, si dhe të japë detaje, në veçanti, për rrezikun që paraqet për shëndetin e njeriut dhe të informojë lidhur me sigurinë</p>	<p>into account and implementing the protection of data that manufacturers and importers have marked as a business secret when submitting such data.</p> <p>15.Manufacturers, importers and distributors of electronic cigarettes and refill containers shall be obliged to establish and maintain a system for collecting information on all suspected harmful effects of these products on human health.</p> <p>16.If any manufacturer, importer or distributor has knowledge or reason to suspect that electronic cigarettes or refill containers in their possession and intended to be placed on the market or have been placed on the market are unsafe or of poor quality or otherwise do not comply with this Law, it shall be mandatory to immediately take all necessary corrective measures to bring that product into compliance with this Law, to withdraw or revoke it, depending on the circumstances of the specific case. In this case, the manufacturer, importer or distributor shall be obliged to immediately inform the market surveillance authorities, where the product is available or intended to be made available, and to give details, in particular, of the risk to human health and safety and the corrective measures taken as well as their results.</p>	<p>sprovodeći zaštitu podataka koje su proizvođači i uvoznici označili kao poslovnu tajnu prilikom dostavljanja takvih podataka.</p> <p>15. Proizvođači, uvoznici i distributeri elektronskih cigareta i posuda za ponovno punjenje dužni su da uspostave i održavaju sistem prikupljanja informacija o svim sumnjama na štetnost ovih proizvoda po zdravlje ljudi.</p> <p>16. Ako bilo koji proizvođač, uvoznik ili distributer ima saznanja ili razlog da sumnja da su elektronske cigarete ili posude za ponovno punjenje, koji su u njihovom posedu i koji su namenjeni za stavljanje u promet ili su stavljeni u promet, nesigurni ili lošeg kvaliteta ili na drugi način nisu u skladu sa ovim zakonom, dužni su da odmah preduzmu sve potrebne korektivne mere da se taj proizvod uskladi sa ovim zakonom, da ga povuku ili opozovu, u zavisnosti od okolnosti konkretnog slučaja. U tom slučaju, proizvođač, uvoznik ili distributer su dužni da odmah obaveste organe za nadzor nad tržištem gde je proizvod dostupan ili nameravaju da ga učine dostupnim, kao i da pruže detalje, posebno, o opasnostima po zdravlje ljudi i bezbednosti i o preduzetim korektivnim merama i njihovim rezultatima.</p>
---	--	---

<p>dhe masat korrigjuese të marra dhe rezultatet e tyre.</p> <p>17.Ministria përgjegjëse për Tregti ka të drejtë të kërkojë nga prodhuesi, importuesi ose distributori informacione shtesë, për aspektet e sigurisë dhe cilësisë, ose për çdo efekt të dëmshëm të cigareve elektronike dhe enëve rimbushse.</p> <p>18.Kur dyshohet se disa cigare elektronike ose enët për rimbushje të importuara sipas rregullave të këtij neni, paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut, Inspektorati i Tregut marrin masa të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>19.Ministria e përgjegjëse për Tregti me akt nënligjorë përcakton shumën e kompensimit proporcional nga paragrafi 7 i këtij Neni.</p>	<p>17.The Ministry responsible for Trade shall have the right to request from the manufacturer, importer or distributor additional information, on safety and quality aspects, or on any harmful effects of electronic cigarettes and refill containers.</p> <p>18.When it is suspected that some electronic cigarettes or refill containers imported according to the rules of this Article present a risk to human health, the Market Inspectorate shall take measures stipulated as per the legislation in force.</p> <p>19.The Ministry responsible for Trade shall, by means of a sublegal act, determine the amount of proportional compensation under paragraph 7 of this Article.</p>	<p>17. Ministarstvo nadležno za trgovinu ima pravo da od proizvođača, uvoznika ili distributera zahteva dodatne informacije, o aspektima bezbednosti i kvaliteta, ili o bilo kakvom štetnom uticaju elektronskih cigareta i posuda za ponovno punjenje.</p> <p>18. Kada se posumnja da neke elektronske cigarete ili posude za ponovno punjenje, uvezene po pravilima ovog člana, predstavljaju opasnost po zdravlje ljudi, Tržišna inspekcija preduzima mere utvrđene u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>19. Ministarstvo nadležno za trgovinu podzakonskim aktom utvrđuje visinu srazmerne naknade iz stava 7. ovog člana.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 33</b> <b>Produktet bimore për tymosje</b></p> <p>1.Çdo paketë njësi dhe paketim i jashtëm i produkteve bimore për tymosje duhet të përmbajnë paralajmërimin si në vijim: <i>»Tymosja e këtij produkti është e dëmshme për shëndetin tuaj.«.</i></p> <p>2.Paralajmërimi shëndetësore nga paragrafi 1 i këtij neni shtypet në sipërfaqen e përparme</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 33</b> <b>Herbal products for smoking</b></p> <p>1. Each unit package and outside packaging of herbal products for smoking must contain the warning as follows: <i>»Smoking this product damages your health.«.</i></p> <p>2.The health warning under paragraph 1 of this Article shall be printed on the front and back</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 33</b> <b>Biljni proizvodi za pušenje</b></p> <p>1.Svako pojedinačno pakovanje i grupno pakovanje biljnih proizvoda za pušenje mora sadržati sledeće upozorenje: <i>»Pušenje ovog proizvoda je štetno po vaše zdravlje«.</i></p> <p>2.Zdravstveno upozorenje iz stava 1 ovog člana štampa se na prednjoj i zadnjoj površini jediničnog</p>

<p>dhe të pasme të paketës njësi dhe paketimit të jashtëm.</p> <p>3.Paralajmërimi shëndetësor duhet të jetë në përputhje me kërkesat nga neni 28 paragrafi 8 i këtij ligji dhe duhet të mbulojë 30% të sipërfaqes së paketës njësi dhe paketimit të jashtëm.</p> <p>4.Paketa njësi dhe paketimet e jashtme të produkteve bimore për tymosje nuk mund të përmbajnë asnjë nga elementet ose karakteristikat e përcaktuara në nenin 32, paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 këtij ligji dhe nuk mund të thuhet se produkti nuk përmban aditivë ose aroma.</p>	<p>surface of the unit package and outside packaging.</p> <p>3.The health warning must be in accordance with the requirements of Article 28 paragraph 8 of this Law and must cover 30% of the surface of the unit package and the outside packaging.</p> <p>4.The unit package and the outside packaging of herbal products for smoking cannot contain any of the elements or characteristics defined in Article 32, paragraph 1, 2, 3 and 4 of this Law and it cannot state that the product does not contain additives or flavours.</p>	<p>pakovanja i spoljašnjeg pakovanja.</p> <p>3.Zdravstveno upozorenje mora biti u skladu sa zahtevima iz člana 28. stav 8. ovog zakona i pokrivati 30% površine jediničnog pakovanja i spoljašnjeg pakovanja.</p> <p>4.Pojedinačno pakovanje i grupno pakovanje biljnih proizvoda za pušenje ne može sadržati nijedan od elemenata ili karakteristika definisanih u članu 32. stavovima 1, 2, 3. i 4. ovog zakona i ne može se reći da proizvod ne sadrži aditive ili arome.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 34</b> <b>Raportimi i përbërësve të produkteve bimore për tymosje</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 34</b> <b>Reporting the ingredients of herbal products for smoking</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 34</b> <b>Prijavlivanje sastojaka biljnih proizvoda za pušenje</b></p>
<p>1.Prodhuesit dhe importuesit e produkteve bimore për tymosje janë të detyruar t'i paraqesin ministrisë përgjegjëse për Tregti e të gjithë përbërësve dhe sasi të tyre sipas emrit të brendit dhe llojit, që përdoren në prodhimin e këtyre produkteve. Prodhuesit ose importuesit janë të detyruar të informojnë ministrinë përgjegjëse për Tregti nëse përbërja e produktit është ndryshuar në lidhje me të dhënat e përcaktuara në bazë të këtij neni. Të dhënat nga ky nen duhet t'i dorëzohet</p>	<p>1.Manufacturers and importers of herbal products for smoking shall be obliged to submit to the responsible Ministry of Trade all ingredients and their quantities by brand name and type, used in the production of these products. Manufacturers or importers shall be obliged to inform the responsible Ministry of Trade if the composition of the product has been changed in relation to the data determined on the basis of this Article. The data under this Article must be submitted to the responsible Ministry of</p>	<p>1.Proizvođači i uvoznici biljnih proizvoda za pušenje dužni su da nadležnom Ministarstvu Trgovine dostave sve sastojke i njihove količine po markama i vrsti, koji se koriste u proizvodnji ovih proizvoda. Proizvođači ili uvoznici dužni su da obaveste Ministarstvo Trgovine ako je sastav proizvoda promenjen u odnosu na podatke utvrđene na osnovu ovog člana. Podaci iz ovog člana moraju se dostaviti Ministarstvu Trgovine pre nego što se novi ili modifikovani biljni proizvod za pušenje stavi na tržište.</p>

<p>ministrisë se përgjegjëse për Tregti përpara se të vendoset në treg një produkt i ri ose i modifikuar bimor për tymosje.</p> <p>2.Ministria përgjegjëse për Tregti publikon të dhënat e dorëzuara në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni në ueb faqen e saj, duke marrë parasysh dhe respektuar mbrojtjen e të dhënave që prodhuesit dhe importuesit i kanë shënuar si sekrete afariste me rastin e dorëzimit të të dhënave të tilla.</p> <p><b>KAPITULLI VII MASAT PËR ULJEN DHE KUFIZIMIN E PËRDORIMIT TË DUHANIT OSE PRODUKTEVE TË NDËRLIDHURA</b></p> <p><b>Neni 35 Ndalimi i reklamimit, promovimit dhe sponsorizimit</b></p> <p>1.Ndalohet reklamimi, promovimi dhe sponsorizimi qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë qoftë në mënyrë të tërthortë i produkteve të duhanit, produkteve të ndërlidhura, produkteve të duhanit me ngrohje, cigareve elektronike duke përfshirë enët për rimbushje, fishekët një-përdorimesh dhe lëngjet që përmbajnë nikotinë, pajisjeve për ngrohjen e produkteve të duhanit me ngrohje dhe</p>	<p>Trade before a new or modified herbal smoking product is placed on the market.</p> <p>2. The responsible Ministry of Trade shall publish the data submitted in accordance with paragraph 1 of this Article on its website, taking into account and respecting the protection of data that manufacturers and importers have marked as business secrets when submitting such data.</p> <p><b>CHAPTER VII MEASURES TO REDUCE AND RESTRICT THE USE OF TOBACCO OR RELATED PRODUCTS</b></p> <p><b>Article 35 Prohibition of advertising, promotion and sponsorship</b></p> <p>1.It shall be prohibited to advertise, promote and sponsor either directly or indirectly tobacco products, related products, heated tobacco products, electronic cigarettes, including refill containers, single-use cartridges and liquids containing nicotine, devices for heated tobacco products with heating and herbal products for smoking.</p>	<p>2.Ministarstvo nadležno za trgovinu objavljuje podatke dostavljene u skladu sa stavom 1. ovog člana na svojoj internet stranici, vodeći računa i poštujući zaštitu podataka koje su proizvođači i uvoznici prilikom dostavljanja tih podataka označili kao poslovnu tajnu.</p> <p><b>POGLAVLJE VII MERE ZA SMANJENJE I OGRAIČAVANJE UPOTREBE DUVANA ILI SRODNIH PROIZVODA</b></p> <p><b>Član 35 Zabrana reklamiranja, promocije i sponzorstva</b></p> <p>1.Zabranjeno je reklamiranje, promovisanje i sponzorisanje, bilo direktno ili indirektno, duvanskih proizvoda, srodnih proizvoda, zagrejanih duvanskih proizvoda, elektronskih cigareta uključujući posude za dopunjavanje, uložaka za jednokratnu upotrebu i tečnosti koje sadrže nikotin, uređaja za zagrevanje duvanskih proizvoda i biljnih proizvoda za pušenje.</p>
---	---	---



<p>produkteve bimore për tymosje.</p> <p>2.Ndalohen të gjitha reklammat, promovimet, sponsorizimet vendore dhe ndërkuftare të ngjarjeve ose aktiviteteve për produktet nga paragrafi 1 i këtij neni dhe asnjë person, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nuk lejohet të:</p> <p>2.1.nxisë asnjë formë të reklamimit, promovimit dhe sponsorizimet;</p> <p>2.2.prodhojë, publikojë, apo të ofrojë qasje në çfarë do reklame, promovimi, ose sponsorizimi;</p> <p>2.3.përfshihet apo të marrë pjesë në ndonjë reklamë, promovim, ose sponsorim si media apo organizator i ngjarjeve, person i famshëm apo pjesëmarrës tjetër, si pranues i çfarëdo kontributi sponsorizues, ose si ndërmjetës që lehtëson ndonjë kontribut të tillë duke përfshirë edhe çdo komunikim komercial, veprim apo praktikë që promovon apo mund të promovojë ndonjë prodhues të duhanit, shitës me shumicë, ose importues drejtpërdrejt apo indirekt.</p> <p>3.Ndalohen të gjitha reklammat, promovimet dhe sponsorizimet e produkteve nga paragrafi</p>	<p>2.All advertisements, promotions, local and cross-border sponsorships of events or activities for the products under paragraph 1 of this Article shall be prohibited and no person, either directly or indirectly, shall be allowed to:</p> <p>2.1.encourage any form of advertising, promotion and sponsorship;</p> <p>2.2. produce, publish, or provide access to any advertising, promotion, or sponsorship;</p> <p>2.3.engage or participate in any advertising, promotion, or sponsorship as a media or event organizer, celebrity or other participant, as a recipient of any sponsorship contribution, or as an intermediary facilitating any such contribution including any commercial communications, action or practice that promotes or may promote any tobacco manufacturer, wholesaler, or importer directly or indirectly.</p> <p>3.All advertisements, promotions and sponsorships of products under paragraph 1 of</p>	<p>2.Zabranjena su sva reklamiranja, promocije, lokalno i prekogranično sponzorstvo događaja ili aktivnosti za proizvode iz stava 1. ovog člana i nijednom licu, bilo direktno ili indirektno, nije dozvoljeno da:</p> <p>2.1.Podstiče bilo koji oblik reklamiranja, promocije i sponzorstva;</p> <p>2.2.Proizvodi, objavljuje ili omogućí pristup bilo kakvoj reklami, promociji ili sponzorstvu;</p> <p>2.3.Se uključi ili učestvuje u bilo kojoj reklami, promociji ili sponzorstvu kao organizator medija ili događaja, kao slavna ličnost ili drugi učesnik, kao primalac bilo kog sponzorskog doprinosa, ili kao posrednik koji omogućáva bilo koji takav doprinos uključujući bilo koju komercijalnu komunikaciju, radnju ili praksu koja promovíše ili može direktno ili indirektno da promovíše bilo kog proizvođača duvana, trgovca na veliko ili uvoznika.</p> <p>3.Zabranjena su sva reklamiranja, promocije i sponzorstva proizvoda iz stava 1. ovog člana koje</p>
---	--	--

<p>1 i këtij neni të sponsorizuara dhe të iniciuara nga ndonjë shtetas i huaj apo vendi në territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p>4.Ndalohet reklamimi i produkteve të cilat sipas këtij ligji nuk janë produkte nga paragrafi 1 i këtij neni por me dukjen e tyre, emërimit dhe qëllimit e përdorimit, nxisin përdorimin e produkteve të duhanit.</p> <p>5.Ndalohet dhurimi i produkteve nga paragrafi 1 i këtij neni nga subjektet që i prodhojnë, i importojnë dhe i tregtojnë ato.</p> <p>6.Ndalohet sponsorimi i programeve në mediat e shkruara dhe elektronike, ngjarjeve apo aktiviteteve nga prodhuesit apo importuesit e produkteve nga paragrafi 1 i këtij neni me qëllim të nxitjes së fshehtë apo të hapur të përdorimit të tyre.</p> <p>7.Promovimi i drejtpërdrejtë i produkteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni përfshin edhe ekspozimin e këtyre produkteve në pozicione të dukshme dhe në pikat e shitjes të çdo lloji, ku shiten këto produkte, duke përfshirë ofertat për to.</p> <p>8.Promovimi i tërthortë i produkteve nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohet edhe organizimi i ngjarjeve ku emri i markës tregtare, emri i variacionit, logoja ose</p>	<p>this Article sponsored and initiated by any foreign citizen or country in the territory of the Republic of Kosovo shall be prohibited.</p> <p>4. It shall be prohibited to advertise products which, according to this Law, are not products under paragraph 1 of this Article, but with their appearance, name and purpose of use, promote the use of tobacco products.</p> <p>5. The donation of products under paragraph 1 of this Article by the entities that produce, import and trade them shall be prohibited.</p> <p>6. It shall be prohibited to sponsor programs in print and electronic media, events or activities by manufacturers or importers of products under paragraph 1 of this Article with the purpose of secretly or openly promoting their use.</p> <p>7. The direct promotion of the products defined in paragraph 1 of this Article shall also include the display of these products in visible positions and at sales points of any type, where these products are sold, including offers for them.</p> <p>8. Indirect promotion of products under paragraph 1 of this Article shall also be considered the organization of events where the trademark name, variation name, logo or other</p>	<p>spozoriše i pokreće bilo koji strani državljanin ili država na teritoriji Republike Kosovo.</p> <p>4.Zabranjeno je reklamiranje proizvoda koji, prema ovom zakonu, nisu proizvodi iz stava 1. ovog člana, ali svojim izgledom, nazivom i namenom upotrebe podstiču upotrebu duvanskih proizvoda.</p> <p>5.Zabranjeno je doniranje proizvoda iz stava 1. ovog člana od strane subjekata koji ih proizvode, uvoze i trguju.</p> <p>6.Zabranjeno je sponzorisanje programa u štampanim i elektronskim medijima, događaja ili aktivnosti proizvođača ili uvoznika proizvoda iz stava 1. ovog člana u cilju tajnog ili otvorenog podsticanja njihove upotrebe.</p> <p>7.Direktna promocija proizvoda iz stava 1. ovog člana obuhvata i izlaganje ovih proizvoda na vidnim mestima i na prodajnim mestima bilo koje vrste na kojima se ti proizvodi prodaju, uključujući i ponude za njih.</p> <p>8.Indirektnom promocijom proizvoda iz stava 1. ovog člana smatra se i organizovanje manifestacija na kojima se navodi naziv trgovinske marke, naziv varijacije, logoa ili druge vizuelne karakteristike</p>
--	--	--

